

VENDIM
Nr. 1, datë 13.1.2015

MBI TARIFAT E UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHOQËRINË UK KORÇË SHA

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, metodologjisë “Për vendosjen e tarifave”, si dhe vendimit të KKRR nr. 22, datë 14.11.2014, “Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore për vitin 2014”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Tarifat për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura për shoqërinë UK Korçë sh.a., për vitin 2015 nuk ndryshojnë.
2. Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2015 mbeten ato të përcaktuara me vendimin nr. 42, datë 23.12.2013 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. UK Korçë”.
3. Pagesa rregullatore për shoqërinë UK Korçë sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave të llogaritura.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe është i vlefshëm deri në miratim e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi